

II. KËRKESAT TEKNIKE PËR ASETIN GJENERUES

Në mënyrë që, asetit gjenerues termik, për tu dhënë me qera së bashku me shërbimet për O&M, të plotësojë nevojat e KESH dhe të trupëzohet me rrjetin e transmetimit duke përdorur infrastrukturën ndërlidhëse që KESH ka në zotërim, ai duhet të jetë në përputhje me kërkesat teknike si më poshtë:

1. Të ketë një fuqi të instaluar prej 110 deri 130 MW. Kapaciteti i instaluar duhet të jetë modular, që të sigurojë fleksibilitet të prodhimit pa cënuar efektivitetin e gjenerimit të impiantit.
2. Imianti të jetë i disponueshëm për tu dhënë me qera për një periudhë jo më pak se 24 (njëzetekatër) muaj, me një klauzole për ndërprerjen e kontratës në 4 (katër) muajt e fundit kundrejt një kompensimi prej jo më shumë se 25% të vlerës së qerasë së mbetur
3. Të përdorë karburant të lëngshëm, si gasoil (LFO) ashtu edhe mazut/solar (HFO)
4. Të ketë një koeficient të gadishmërisv jo më të vogël se 0.85
5. Të funksionojë brenda përcaktimeve të ligjeve shqiptare për ndotjen mjedisore
6. Të furnizojë energjinë elektrike në tensionin 220kV/50Hz duke respektuar parametrat e sigurisë së Sistemit Energjitik Shqiptar.
7. Të jetë i disponueshëm për tu instaluar pranë TEC Vlora për të shfrytëzuar infrastrukturën ndërlidhëse me rrjetin e transmetimit të TEC-it (Linja 220kV TEC Vlorë – Nënstacioni Babicë)
8. Të jetë një impiant i lundrueshëm, që të mos zërë hapësirat dhe të mos pengojë aktivitetet për konservimin apo rehabilitimin e TEC-it, gjatë periudhës së qiradhënies.
9. Shërbimi për transmetimin e energjisë nga vendndodhja e impiantit deri tek terminallet e linjes TEC Vlorë-NN Babicë, që ndodhen brenda ambienteve të TEC Vlora (jo më larg se 1000m), të sigurohet nga qiradhënësi.

III. PROCEDURA E APLIKIMIT

Procedura për dorëzimin, pranimin dhe vlerësimin e ofertave të Shprehjes së Interesit, do të kryhet në përputhje me rregullat e mëposhtme:

- Oferta për Shprehjen e Interesit mund të paraqitet nga çdo operator ekonomik, (shoqëri e vetme ose grup shoqërisht të bashkuara në një operator për këtë qëllim) që plotëson kushtet dhe kërkesat e kësaj procedure. Në rast të një grupi shoqërisht, në Shprehjen e Interesit duhet të

përfshihet edhe marrëveshja për konstituimin e grupit, duke deklaruar edhe shoqërinë udhëheqëse e cila do të veprojë si përfaqësuese e grupit. Përsa i përket pranimit dhe vlerësimit të ofertës, grupi do të konsiderohet se plotëson kriterin kur të paktën një pjestar i grupit e plotëson atë.

- Operatori i interesuar duhet të dorëzojë në zyrat e KESH sh.a., ofertën për Shprehjen e Interesit së bashku me dokumentacionin shoqërues, jo më vonë se ora 14:00 të datës 27 Janar 2021.
- Operatori I Interesuar duhet që, brenda afatit të sipërpërmendur, mund ta dergojë me e-Mail kopjen e skanuar të ofertës për Shprehjen e Interesit bashkë me dokumentacionin shoqërues, në adresën dot@kesh.al. Gjithësesi, operatori që ka shprehur interesin ka detyrimin që përpara nënshkrimit të marrëveshjes së qeradhënies, të dorëzojë në KESH kopjen fizike të Shprehjes së Interesit dhe dokumentacionit shoqërues me dokumenta origjinale ose kopje të noterizuara të autentifikuara me vulën apostile dhe të përkthyer në shqip.
- Shprehja e Interesit e cila nuk do të paraqitet në formën e dokumentacionit fizik, siç kërkohet më sipër, do të konsiderohet e pavlefshme dhe do të anashkalohet.
- Brenda 1 (nje) jave nga afati i dorëzimit, KESH sh.s. do të shqyrtojë dhe vlerësojë Shprehjet e Interesit që janë dorëzuar, për përputhshmërinë me kërkesat dhe kriteret e paraqitura në këtë Thirrje për Shprehje Interesi si dhe me përcaktimet e bëra në pikën VIII të amendimit të VKM Nr. 620, datë 22 Tetor 2021.
- Njoftimi për vlerësimin e ofertave të Shprehjes së Interesit do të publikohet dhe do të bëhet me dije operatorëve pjesëmarrës, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i procesit të vlerësimit.

V. KRITERET KUALIFIKUESE EKONOMIKE DHE LIGJORE

Operatorët që do të shprehin interes ndaj kësaj Thirrjeje, duhet të provojnë plotësimin e kriterëve kualifikuese ekonomike dhe ligjore duke dorëzuar dokumentacionin mbështetës si më poshtë

- Dokumentacioni që vërteton regjistrimin e shoqërisë në regjistrat tregtar/gjyqësore të vendit ku shoqëria është themeluar ose regjistruar
- Dokumentacion nga regjistrat tregtar të vendit ku subjekti ka selinë ku tregohet vlera e kapitalit të regjistruar, që nënkupton vlerën e kapitalit të shoqërisë të përbërë nga vlerë e asetëve apo likuiditeteve dhe që paraqitet në ekstraktet e regjistrave tregtar;
- Vërtetim që subjekti nuk është në proces likuidimi/falimentimi dhe kapitalet/asetet e tij nuk janë objekt i procedurave përmbarimore në vendet ku ushtron aktivitetin;

- Një dokument të lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës, jo më i vjetër se 3 muaj nga data e paraqitjes së Ofertës për Shprehje Interesi, i cili të vërtetojë se kompania dhe përfaqësuesi ligjor i kompanisë:
 - nuk ndiqen penalisht për shkelje penale për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike
 - nuk janë dënuar me vendim gjykate për vepra penale që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike apo vepra të tjera penale (pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, pastrim parash, falsifikim, shpërdorim detyre, vjedhje, pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës dhe veprat penale në fushën e falimentit)
 - nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë për veprimtari që lidhet me aktivitetin e profesional;Nëse shteti i regjistrimit të shoqërisë nuk lëshon një nga dokumentet e mësipërme, atëherë shoqëria dorëzon një vetëdeklarim.
- Vërtetim ose deklaratë që subjekti ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore/shëndetësore në përputhje me legjislacionin e shtetit përkatës;
- Pasqyrat financiare të subjektit të licencuar, të vitit të fundit, të certifikuar sipas rregullave të shtetit përkatës ku shoqëria ushtron aktivitetin, me qëllim vlerësimin e ecurisë financiare të subjektit të interesuar nga i cili të evidentohet edhe vlerë e kapitalit të shoqërisë;
- Dokumentacioni përkatës teknik dhe ligjor mbështetës, për kapacitetet e kërkuara teknike dhe të aktivitetit nëpërmjet të cilave vlerëson se do të përmbushë detyrimet që do të rrjedhin nga kontratë e qirasë së asetit gjenerues termik., si dhe pa u kufizuar, kontrata të ngjashme qiraje, kontrata të shërbimeve të operimit të aseteve gjeneruese termike si dhe kontrata të ngjashme për mirëmbajtjen e këtyre aseteve. Për qëllime të evidentimit të sa më sipër, subjekti i interesuar duhet të dorëzojë në formë shkresore:
 - Një profil të shoqërisë që shpreh interesin i cili të përshkruajë kapacitetet e saja për përmbushjen e kërkesave të KESH për shkëmbim
 - Një përshkrim të proceseve që subjekti vlerëson se do të aplikojë me qëllim përmbushjen e kërkesave të KESH për marrjen me qera të një aseti gjenerues termik, këto të shoqëruara me dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj pike.
 - Dokumenta që tregojnë se po kryen ose ka kryer, në të paktën 2 (dy) raste, shërbime elektro-mekanike për operimin dhe mirëmbajtjen e impianteve gjeneruese termike me fuqi të instaluar jo më pak se 100MW
 - Dokumenta që tregojnë se po kryen ose ka kryer shërbime elektro-mekanike për operimin dhe mirëmbajtjen e impianteve gjeneruese termike që operojnë të lidhura me rrjetin e transmetimit të energjisë.

- Dokumenta që tregojnë se po kryen ose ka kryer, në të paktën 1 (një) rast, punime ndertimi apo shërbimesh të tjera për nënstacione që punojnë me tension jo më pak se 220kV.

• Me qëllim që të provojë aftësitë për kryerjen e shërbimeve të O&M së një impianti gjenerues lundruës, subjekti i interesuar duhet të paraqesë një structure personeli dhe një listë të punonjësve me pozicionet, detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse, të mbështetur me CV ku demonstrohen kualifikimet dhe përvoja e nevojshme për punonjësit e pozicioneve drejtuese. Struktura e personelit duhet të mbulojë, me numrin e duhur të punonjësve, të gjitha fushat ekspertizës së nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të operimit dhe mirëmbajtjes së impiantit, duke paraqitur minimalisht por pa u kufizuar në pozicionet si:

- Inxhinierë Mekanikë
- Inxhinierë Elektrikë
- Specialistë mekanikë me përvoje në operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mekanike të impiantit
- Specialistë elektrikë me përvoje në operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike të impiantit
- Specialist i çertifikuar për shëndetin dhe sigurinë në punë (HSE),

• Për të demonstruar aftësitë operacionale dhe manaxhuese, si dhe përgjegjshmërinë social – mjedisore në përputhje me standardet ndvrkombëtare për shërbimet e ofruara, operatorët e interesuar duhet të paraqesin:

- Një certificate të njohur ndërkombëtare, si NEBOSH, IOSH ose ekuivalente;
- Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.
- Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ISO 45001:20018 e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.
- Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

- Certifikatë për Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001:2017, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

• Deklaratë dhe dokumenta nga subjekti, që disponon apo ka në përdorim një aset gjenerues termik të cilin mund ta japë në përdorim të shoqërisë KESH sh.a. nëpërmjet një kontrate qiraje.

• Deklaratë për të dhënat teknike të asetit gjenerues që ofron për qiradhënie e cila të përmbajë, por pa u kufizuar:

- * Kapacitetin e instaluar (fuqia)
- * Përshkrim të teknologjisë së prodhimit të energjisë

- * Lëndën djegëse që përdor aseti për qëllime gjenerimi
- * Konsumin specifik për njësi të prodhimit (MWh)
- * Koeficientin e disponueshmërisë vjetore të asetit
- * Të dhëna mbi emetimet e gazrave serë në atmosferë bazuar në llojin lëndës djegëse të përdorur (nëse ka alternativa)

- Deklaratë se operatori i interesuar ka aftësitë teknike dhe operacionale si dhe do të realizojë, brenda çmimit të ofruar të qerasë, të gjitha aktivitetet për ankorimin, mirëmbajtjen, operimin dhe furnizimin me materiale ndihmëse të impantit, duke kryer dhe mbuluar kostot për punimet konstruktive e shërbimet e nevojshme për funksionimin e impiantit..

- Operatori i interesuar duhet të dorëzojë një sigurim ose ndonjë instrument tjetër garancie për ofertën

- Deklaratat duhet të shoqërohen me dokumentacion teknik dhe ligjor që i provojnë dhe i mbështesin ato.

VI. RRETHANAT DHE AKTIVITETET PËR INSTALIMIN DHE OPERIMIN E ASETIT TË DHËNË ME QERA

KESH sh.a., nëpërmjet shoqërisë bijë TEC-Vlora sh.a., ka ne administrim një impiant gjenerues termik me cikël të kombinuar prej 97MW (TEC-in e Vlorës), I cili aktualisht nuk funksionon dhe mbahet në gjendje konservimi.

Impianti ndodhet në Pyllin e Sodës, në very të qytetit të Vlorës, buzë detit dhe pranë portit të peshkimit të Triportit (jo më larg se 1000m).

TEC-i Vlorës lidhet me rrjetin e transmetimit të Shqipërisë nëpërmjet linjës së transmetimit të tensionit të lartë TEC Vlora – NS Babicë (220kV/50Hz) dhe ka të vendosura depozita karburanti për depozitimin e karburanteve të lëngshëm.

Për shkak të vendndodhjes dhe përparësive infrastrukture, impianti gjenerues preferohet të jetë i lundrueshëm dhe të pozicionohet brenda basenit të Triport-it duke mundësuar distancën e shkurtër të lidhjes me терминаlet e linjës së transmetimit të TEC-it (lutemi ti referoheni vizatimeve bashkëlidhëse). KESH do të sigurojë të drejtat e përdorimit të basenit të Triport-it për vendosjen e impiantit.

Qiradhënësi do të sigurojë KESH sh.a., një impiant termik për gjenerimin e energjisë elektrike në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të bëra prezente në këtë Thirrje si dhe do të kryejë, nën përgjegjësinë e vet, të gjitha aktivitetet e nevojshme për:

- Ankorimin e impiantit lundrues duke garantuar sigurinë e tij dhe të mjeteve Brenda basenit

- Ndërlidhjen me rrjetin e transmetimit në përputhje me kërkesat për sigurinë e sistemit.
- Mirëmbajtjen e impiantit sipas manualeve dhe procedurave që garantojnë operimin e sigurtë dhe të qendrueshëm të tij.
- Operimin e impiantit sipas metodologjisë së shfrytëzimit dhe specifikimeve të shërbimit të dakordësuar

KESH sh.a. garanton qiradhënësin se zotëron të drejtat e përdorimit të hapësirës së nevojshme për ankorimin e impiantit lundruar.

KESH sh.a. do të jetë përgjegjës për të drejtën e lidhjes së impiantit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet pikëlidhjes së linjës që ka TEC-i i Vlorës.

KESH sh.a. do të jetë përgjegjës për kryerjen e të gjitha procedurave me qëllim prokurimin dhe furnizimin e impiantit me karburantin e nevojshëm për funksionim sipas metodologjisë së dakordësuar të shfrytëzimit.

VII. FORMA E SHPREHJES SË INTERESIT

Operatorët e interesuar, që do të përgjigjen kësaj Thirrjeje, duhet ta dorëzojnë propozimin e tyre KESH sh.a. në një formë që duhet të përmbajë, përveç dokumentacionit të sipër përmendur, por pa u kufizuar, edhe deklaratat dhe informacionin e mëposhtëm:

- Çmimin e qerasë për agjenerues
- Propozimin teknik duke përfshirë:
 - * Të dhënat teknike të impiantit
 - * Periudhën kohore dhe përshkrimin e aktiviteteve të nevojshme për trupëzimin funksional të impiantit (ankorimin dhe lidhjen me rrjetin e transmetimit)
 - * Përshkrimin e aktiviteteve për operimin dhe mirëmbajtjen e impiantit
 - * Propozimin e termave dhe metodologjisë për koordinimin e aktiviteteve të furnizimit me karburant dhe shfrytëzimit të impiantit

- Një deklaratë të dakordësimit me kërkesat dhe kriteret e bëra prezente në këtë Thirrje për Shprehje Interesi

- Një deklaratë për vlefshmërinë e ofertës së paraqitur, deri në daljen e lejes mjedisore.

- Një siguracion ose ndonje instrument tjetër garancie të ofertës së paraqitur për shumën prej 100,000 (njëqindmijë) Euro

- Një deklaratë aprovimi për garantimin në të ardhmen të kontratës së qerasë me police sigurimi apo ndonje instrument tjetër garancie për të paktën 10% të vlerës së kontratës

VIII. PROÇESI I VLERËSIMIT

KESH sh.a. do të kryejë vlerësimin e propozimeve të ofruara duke u angazhuar të respektojë parimet themelore të garës siç janë; trajtimi i barabartë, mos-diskriminimi, konfidencialiteti dhe transparenca.

Shprehjet e Interesit do të shqyrtohen nga KESH sh.a. sipas dokumentacionit të paraqitur nga operatorët e interesuar me bazë krahasimore duke përdorur analiza dhe gjykim profesional e në përputhje me kërkesat kualifikuese dhe kriteret vlerësuese.

Proçesi i vlerësimit do të kryhet me dy faza:

Vlerësimi Kualifikues – Në këtë faze, dokumentacioni i propozimeve të paraqitura nga operatorët e interesuar do të gjykohet për përputhshmërinë me përcaktimet ligjore e kriteret kualifikuese dhe plotësimin e kërkesave teknike.

Vlerësimi Selektiv - Gjatë kësaj faze KESH sh.a. do të shqyrtojë ofertat financiare dhe propozimet teknike, duke synuar një vlerësim krahasimor të propozimeve, bazuar në kriteret selective me rëndësi specifike si me poshtë:

1Çmimi i Qerasë Mujore për Kapacitetin e instaluar Pikët maksimale do ti jepen ofertës me çmimin më të ulët.

Ofertat e tjera do të marrin pikëzohen në raport me çmimin më të ulët të ofertuar.

Dmth: $\text{Pikët e ofertës X} = \frac{\text{Çmimi më i Ulët i ofertuar}}{\text{Çmimi i ofertës X}} * \text{Pikët maksimale}$
40 pikë

2Rendimenti i konvertimit të karburantit në energji nga impianti Pikët maksimale do ti jepen ofertës me rendimentin më të lartë

Ofertat e tjera do të marrin pikëzohen në raport me rendimentin më të lartë të ofertuar.

Dmth: $\text{Pikët e ofertës X} = \frac{\text{Rendimenti i ofertës X}}{\text{Rendimenti më e Lartë i ofertuar}} * \text{Pikët maksimale}$
20 pikë

3.Periudha kohore për instalimin dhe trupëzimin funksional të impiantit. Pikët maksimale do ti jepen ofertës me periudhën më të shkurtër.

Ofertat e tjera do të marrin pikëzohen në raport me periudhën më të shkurtër të ofertuar.

Dmth: $\text{Pikët e ofertës X} = \frac{\text{Periudha e ofertës X}}{\text{Periudha më e Shkurtër e ofertuar}} * \text{Pikët maksimale}$
20 pikë

4. Koeficienti Vjetor i disponueshmërisë së Impiantit (Koeff. Vjetor ≤ 1) Pikët maksimale do të jepen ofertës me koeficientin më të lartë

Ofertat e tjera do të marrin pikëzohen në raport me koeficientin më të lartë të ofertuar.

Dmth: Pikët e ofertës X = Koeficienti i ofertës X / Koeficienti më i Lartë i ofertuar * Pikët maksimale 20points

Në përfundim të procesit të vlerësimit, KESH sh.a. do të informojë operatorët e interesuar për rezultatin e vlerësimit dhe, në rast të paraqitjes së një propozimi ekonomikisht të pranueshëm, do të iniciojë procedurat për negocijimin e kontratës së qerasë me ofertuesin që ka bërë propozimin më të mire.

IX. PARASHIKIMET KONTRAKTUALE

Me qëllim që ti paraprijnë finalizimit të kontratës së qerasë, të dyja palët KESH sh.a. dhe qiradhënësi, duhet të angazhohen që të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet për nxjerrjen e lejes mjedisore dhe të gjitha licensave e lejeve të nevojshme për instalimin dhe operimin e impiantit lundrues për gjenerim energjie pranë TEC-it të Vlorës, sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar

Të gjitha shpenzimet, që KESH sh.a. do të kryejv gjatë fazes së instalimit për lejet dhe licensat e nevojshme do të mbulohen nga qiradhënësi. Këto shpenzime do të bëhen me dije qiradhënësit gjatë negocijimit të kontratës së qerasë.

Hyrja në fuqi dhe fillimi i Kontratës së Qerasë do të jenë të kondicionuara nga:

1. Dalja e Lejes Mjedisore dhe të gjitha lejeve apo licensave të tjera të nevojshme për të filluar shfrytëzimin e impiantit
2. Aprovimin e detyrueshëm të Marrëveshjes së Qerasë nga organet drejtuese të shoqërisë